

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6704  
E martë, 13 shtator 2022  
çmimi 0.40 €

KMDLNj: Refuzimi i Kurtit për ta takuar Jasharajn e vështirëson situatën | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TË HËNËN NË SLLOVENI ËSHTË MBAJTUR  
SAMITI I PROCESIT BËRDO - BRIONI | FAQE 4-5

## NË SAMITIN E BËRDO - BRIONIT I BËHET THIRRJE BE-së QË KOSOVËS T'I HIQEN VIZAT



Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, i bëri thirrje Bashkimit Evropian që t'ia ofrojë Kosovës liberalizimin e vizave, ndërsa Bosnjë-Hercegovinës statusin e shtetit kandidat deri në fund të vitit 2022. Pahor i bëri komentet në fund të samitit të procesit Bërdo-Brioni,

që u mbajt të hënën në Bërdo të Sllovenisë. Kjo thirrje, tha ai, është edhe pjesë e gjashtë konkluzioneve që u miratuan pas samitit. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka theksuar se aktualisht nuk ka vend në BE që thotë se është kundër liberalizimit të vizave

### AKTUALE




MBRETI CHARLES III PREMTON  
SE DO TA NDJEKË SHEMBULLIN  
E NËNËS | F. 2

BIEN RASTET E TË INFektUARVE ME  
COVID NË KOSOVË | F. 3

ABETARJA E PËRBASHKËT UNIKE  
KOSOVË - SHQIPËRI PROMOVHET  
EDHE NË TIRANË | F. 7

### EKONOMI



MBI 37 MIJË VIZITORË VENDAS E TË  
HUAJ QËNDRUAN NË HOTELET E  
KOSOVËS NË MUAJIN QERSHOR | F. 8

BESNIK TAHIRI: BIZNESET JANË NË  
PRAG TË FALIMENTIMIT | F. 8

### SPORT



SONTE SUPERNDESHJA  
BAYERN - BARCELONA | F. 10



HAXHIU E ÇON  
NË PROKURORI  
RAPORTIN E  
INSPEKTORATIT  
PËR RASTIN  
DEHARI,  
DYSHOHET PËR  
MANIPULIME TË  
PROVAVE | FAQE 3



ISH-SHEF I OSBE-së: UNMIK-u DHE  
QEVERIA E ATËHERSHME S'I NDIHMUAN  
TË DHUNUARAT GJATË LUFTËS | FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Mbreti Charles III premtion se do ta ndjekë shembullin e nënës



LONDËR, 12 SHTATOR - Mbreti Charles III tha para Parlamentit të Britanisë të hënën se është “i vendosur që me besnikëri” ta ndjekë shembullin e nënës së tij, Mbretëreshës Elizabeth II, teksa shtoi se deputetët britanikë janë “instrumenti i demokracisë sonë”. Gjatë ceremonisë në Parlament, Charles e shfrytëzoi këtë adresim për ta nderuar nënën e tij dhe u zotua se do t'i respektojë parimet e qeverisjes

kushtetuese. “Në kohën kur ishte shumë e re, Mbretëresha u zotua se do të shërbente për shtetin dhe popullin e saj dhe t'i ruante parimet e çmueshme të qeverisjes kushtetuese që janë në zemër të shtetit tonë. Këtë premtim ajo e respektoi me përkushtim të madh”, tha ai para ligjvënësve, duke theksuar se ajo vendosi shembull për shërbim “të cilin, me ndihmën e Zotit dhe këshillën tuaj, jam i vendosur që ta ndjek me

besnikëri”, shtoi ai. Mbretëresha Elizabeth II, 96-vjeçare, vdiq në shtëpinë e saj në Skoci më 8 shtator. Trashëgimtari i fronit është djali i saj i madh, Charles, i cili do të njihet me emrin Mbreti Charles III. Britania është monarki kushtetuese dhe demokracia parlamentare funksionon që nga viti 1688. Mbretëresha Elizabeth II do të varroset më 19 shtator në Londër.

## Scholz shpreh keqardhje për mosgatishmërinë e Iranit për marrëveshjen bërthamore

BERLIN, 12 SHTATOR - Kancelari gjerman Olaf Scholz ka shprehur keqardhje që Irani nuk është pajtuar me propozimet e shteteve evropiane për ringjallje të marrëveshjes bërthamore. Sipas tij, një refuzim i tillë zvogëlon mundësitë për arritje të marrëveshjes “në të ardhmen e afërt”. “Më vjen keq që Irani nuk ka dhënë përgjigje pozitive për propozimet e bëra nga koordinatoret evropiane”, ka thënë ai në një konferencë për medie në Berlin, duke shtuar se Irani nuk ka arsye që të mos

pajtohet me këto propozime. Gjermania është një prej tri shteteve evropiane bashkë me Francën dhe Britaninë që kanë nënshkruar marrëveshjen bërthamore me Iranin. Vendet e tjera që kanë nënshkruar marrëveshjen janë: Kina, Rusia, si vende anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, plus Bashkimi Evropian. Irani e ka nënshkruar marrëveshjen bërthamore me fuqitë botërore më 2015. Sipas marrëveshjes, Teherani

është pajtuar për ta kufizuar aktivitetin bërthamor në këmbim të heqjes së sanksioneve. Më 2018, ish-presidenti amerikan Donald Trump, i ka larguar Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja dhe ka rikthyer sanksionet ndaj Iranit. Me ardhjen e Joe Bidenit në krye të ShBA-së janë rritur shpresat për ringjallje të marrëveshjes. Palët kanë mbajtur disa raunde takimesh në Vjenë me qëllim të ringjalljes së marrëveshjes, por palët ende nuk janë pajtuar për një tekst final.



## Zelanda e Re heq pothuajse të gjitha kufizimet e lidhura me Covid-19



WELLINGTON, 12 SHTATOR - Vizitorëve në Zelandë të Re nuk do t'u kërkohet të jenë të vaksinuar kundër koronavirusit për të hyrë në shtet, ka thënë kryeministria e këtij vendi, Jacinda Ardern. Ky shtet nuk do të kërkojë më as vendosjen e maskës, përveç në spitale dhe shtëpi të kujdesit për të moshuarit. “Është koha që në mënyrë të sigurt të kalojmë në kapitullin e ri të menaxhimit të koronavirusit dhe të jetojmë pa masat e jashtëzakonshme që i kemi miratuar më parë”, ka thënë Ardern.

Ky shtet i pati mbyllur kufijtë për pothuajse të gjithë njerëzit në mars të vitit 2020. Autoritetet i kanë hapur tërësisht kufijtë vetëm në korrik të këtij viti. Ardern ka bërë me dije se kërkesa që turistët të testohen para se të hyjnë në Zelandë të Re do të jetë vetëm rekomandim dhe jo detyrim. Në mesin e ndryshimeve të tjera është edhe ajo që vetëm të infektuarit duhet të izoloohen për shtatë ditë dhe jo rastet e kontaktit. Zelandë e Re, shtet me rreth pesë milionë banorë, ka raportuar më

shumë se 1.7 milion raste me koronavirus dhe rreth 2 000 viktima prej shpërthimit të pandemisë. Për koronavirusin e ri, që shkakton sëmundjen Covid-19, është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës. Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin pandemi më 11 mars të vitit 2020. Deri më tani janë regjistruar mbi gjashtë milionë njerëz të vdekur me këtë virus.

## OKB-ja: 50 milionë njerëz i nënshtrohen skllavërisë moderne

NJU-JORK, 12 SHTATOR - Numri i njerëzve që bëjnë punë të detyrueshme apo që janë të martuar kundër dëshirës së tyre, shkon në gati 50 milionë në vitet e fundit, ka thënë Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Punën. Në raportin më të ri të kësaj agjencie është thënë se krizat sikurse pandemia e

koronavirusit, konfliktet e armatosura dhe ndryshimet klimatike kanë rritur pengesat në punësim dhe edukim. Për pasojë, është rritur varfëria ekstreme dhe migrimi i detyrueshëm, është thënë në raport. Kombet e Bashkuara kanë synim t'i zhdukin të gjitha format e skllavërisë moderne deri më 2030,

mirëpo numri i njerëzve që u nënshtrohen këtyre abuzimeve është rritur për 10 milionë në periudhën 2016-2021. Sipas studimit, deri në fund të vitit të kaluar 28 milionë njerëz kanë bërë punë të detyrueshme, ndërsa 22 milionë janë detyruar të jetojnë në martesë të padëshiruara.



# Haxhiu e çon në Prokurori raportin e Inspektoratit për rastin Dehari, dyshohet për manipulime të provave

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në një konferencë për medie ka prezantuar një raport me gjetjet e Inspektoratit të kësaj ministrie për rastin e vdekjes së ish-aktivistit të Vetëvendosjes, Astrit Dehari. Sipas Haxhiut, ky raport lë dyshime të mëdha për manipulim të provave dhe deklaratave të aktorëve të përfshirë në këtë rast. “Më 5 nëntor të vitit 2016, në rrethana ende të pasqaruara, ka ndërruar jetë Astrit Dehari. Lidhur me këtë, gjatë kësaj kohe, që nga marrja e detyrës, nga zyrtarë të ndryshëm kemi pranuar informata të ndryshme lidhur me përfshirjen e personave përgjegjës në këtë rast. Për të

sqaruar, zbatimin e procedurave brenda ShKK, nëse zyrtarët përgjegjës kanë zbatuar përgjegjësitë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, kam kërkuar inspektim dhe, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e këtij rasti dhe rëndësinë për njoftim të qytetarëve në raport me këtë, më lejoni që sot t'i adresoj gjetjet e inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë”, ka pohuar ajo, duke theksuar se Inspektorati ka gjetur shkeljet si në vijim: “Marrja dhe posedimi i incizimeve të kamerave me aprovim të ish-drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren, Destan Zogaj, te zyrtarët Ylber Topalli, Burim Buleshkaj dhe anëtarë të komisionit të ShKK-së përben shkelje të legjislacionit penal dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave. Është e

rëndësishme të theksohet se, sipas Inspektoratit, incizimet e kamerave të sigurisë nga kryeinspektori i MD dhe zyrtarët e ShKK-së janë marrë para se ato t'i merrte policia, nga data 5(KUR KA NDODHUR RASTI) dhe datat 6, 7 nëntor 2016. Pra është e çuditshme se si zyrtarët korrektues dhe kryeinspektori i MD-së kanë marrë kamerat e sigurisë para organeve të ndjekjes”, ka thënë Haxhiu.

Ajo ka theksuar se, sipas legjislacionit në fuqi, në rast të ndonjë veprimi me elemente të natyrës penale, autoriteti kompetent për marrjen e incizimeve është policia. “Në anën tjetër, zyrtarët e institucionit mund të kenë qasje në incizimet, por assesi t'i marrin ato përmes USB-së dhe assesi para policisë. Sipas

raportit të Inspektoratit, kryeinspektori në vitin 2016, lidhur me rastin në fjalë, ka nxjerrë dy raporte, kontradiktore, njëra më 14.11.2016 dhe tjetra me datë 21.11.2016. Në raportin e parë të kryeinspektorit thuhet se po bëhet inspektim i jashtëzakonshëm duke e cilësuar rastin si vetëvrasje, duke tejkaluar kështu kompetencat ligjore si kryeinspektorë, ndërsa në raportin e datës 21.11.2016 bën sërish inspektim dhe shkruan me rastin e vdekjes së A. D. Këto dy raporte janë të nënshkruara nga kryeinspektori Ylber Topalli. Raportin e datës 14 ky i fundit e mohon që është i shkruar nga ai dhe rrjedhimisht e konteston si të tillë. Tani u takon organeve të ndjekjes që ta zbardhin nëse ky raport është i falsifikuar. Nëse

po, nga kush apo nëse kryeinspektori nuk po e thotë të vërtetën”, ka thënë ministrja Haxhiu.

Ajo ka shtuar se Inspektorati ka trajtuar edhe shqiptimin e masave ndaj personave përgjegjës dhe transferet e tyre në qendrën e paraburgimit në Lipjan. “Në vend të suspendimit të menjëhershëm të stafit përgjegjës në qendrën e paraburgimit në Prizren ata kanë vazhduar të jenë në punë deri me datë 21 nëntor 2016 ku le hapësirë për manipulim të provave dhe dëshmime. Është, po ashtu e çuditshme dhe e paprecedent, që dëshmitari kryesor në rastin e A. D., Naser Makolli, është transferuar me datë 9 dhjetor në Lipjan, ku parapakisht në qendrën e njëjtë ishin transferuar edhe oficerët me masën disiplinore të transferimit. Me fjalë të tjera, po i bie që në qendrën në Lipjan janë transferuar edhe zyrtarët përgjegjës, po ashtu edhe dëshmitari kryesor Naser Makolli, me ç'rast dëshmitari kryesor kishte ndërruar jetë po aty. A mendoni se kjo mund të jetë një rastësi?! Po ashtu raporti adreson edhe deklaratat kontradiktore të zyrtarëve përgjegjës dhe çështje të tjera”, ka thënë ajo, duke shtuar se mbi bazën e këtij raporti konstatohen veprime kontradiktore, të paqarta dhe lihen dyshime të mëdha për manipulim të provave dhe deklaratave të aktorëve të përfshirë në rast, prandaj thërrasim prokurorinë të ndërmarrë masa adekuate dhe cilësore për zbardhjen e së vërtetës në rastin Dehari”, ka pohuar ministrja. Haxhiu ka thënë se pas këtij raporti do t'i ndërmarrin dy veprime konkrete. “Ky raport me të gjitha shkresat përcjellëse do të dërgohet te kryeprokurori i shtetit. Do të dërgohet në organet përgjegjëse që kanë autorizime për shqiptimin e masave ndaj aktorëve të përfshirë në rast. Ministria e Drejtësisë do të ofrojë gjithë mbështetjen për institucionet që ky rast të zbardhet”, ka thënë ministrja Haxhiu.

## Bien rastet e të infektuarve me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 102 testeve të realizuara, janë konfirmuar vetëm katër raste me Covid-19. Sipas raportit të MSh-së, 49 persona janë shëruar nga ky virus.

Raste aktive me Covid aktualisht janë 196. Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka miratuar rekomandimin e komitetit për imunizimin e popullatës me vaksinën kundër Covid-19, ku lejohet vaksinimi me dozën e katërt për të gjithë personat e

grupmoshës mbi 50-vjeçare (të paktën katër muaj pas marrjes së dozës së tretë), personat me sëmundje kronike dhe imunitet të dobësuar të moshës mbi pesëvjeçare (të paktën katër muaj pas marrjes së dozës së tretë) si dhe për profesionistët shëndetësorë pa dallim moshe.





TË HËNËN NË SLOVENI ËSHTË MBAJTUR SAMITI I PROCESIT BËRDO - BRIONI

# Në Samitin e Bërdo - Brionit i bëhet thirrje BE-së që Kosovës t'i hiqen vizat

Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, i bëri thirrje Bashkimit Evropian që t'ia ofrojë Kosovës liberalizimin e vizave, ndërsa Bosnjë-Hercegovinës statusin e shtetit kandidat deri në fund të vitit 2022. Pahor i bëri komentet në fund të samitit të procesit Bërdo-Brioni, që u mbajt të hënën në Bërdo të Sllovenisë. Kjo thirrje, tha ai, është edhe pjesë e gjashtë konkluzioneve që u miratuan pas samitit. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka theksuar se aktualisht nuk ka vend në BE që thotë se është kundër liberalizimit të vizave

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 12 SHTATOR** - Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, i bëri thirrje Bashkimit Evropian që t'ia ofrojë Kosovës liberalizimin e vizave, ndërsa Bosnjë-Hercegovinës statusin e shtetit kandidat deri në fund të vitit 2022. Pahor i bëri komentet në fund të samitit të procesit Bërdo-Brioni që u mbajt të hënën në Bërdo të Sllovenisë. Kjo thirrje, tha ai, është edhe pjesë e gjashtë konkluzioneve që u miratuan pas samitit. Përveç Pahorit, nikoqir i ngjarjes, aty morën pjesë edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i Malit të Zi, Millo Gjukanoviç, i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, i

Kroacisë, Zoran Millanoviç, si dhe anëtarët e presidencës trepalëshe të Bosnjës, Shefik Xhaferoviç, Millorad Dodik dhe Zheko Komshiq. Pahor ka thënë se me udhëheqësit e vendeve të rajonit është rënë dakord që bisedimet të jenë mënyra e vetme për zgjidhjen e çështjeve të hapura. "Samiti u mbyll me sukses për dy arsye: diskutimet kanë qenë mjaft të mira dhe kemi këmbëngulur që të jemi më të bashkuar. Ka disa gjëra që na ndajnë, por duhet të kuptojmë se ku janë këto dallime", ka deklaruar Pahor, duke mos dhënë shumë detaje, por duke thënë se besimi midis vendeve nuk është në nivelin më të lartë të mundshëm. Në konkluzionet e miratuara theksohet edhe rëndësia e zgjerimit të BE-së me vendet e

mbetura të Ballkanit Perëndimor.

Ky proces konsiderohet si "kontributi më i drejtpërdrejtë në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në rajon". "1. Ritheksojmë rëndësinë e zgjerimit të BE-së si kontributi më i drejtpërdrejtë për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon, zgjerimi është më shumë se gjeopolitikë; 2. Ne bëjmë thirrje për një proces më të shpejtë të integritetit në BE në përputhje me kushtet e njohura për anëtarësim; 3. Ne bëjmë thirrje për dhënien e statusit kandidat për Bosnjë-Hercegovinën deri në fund të vitit 2022; 4. Ne bëjmë thirrje për heqjen e regjimit të vizave për të gjithë Ballkanin Perëndimor deri në fund të vitit 2022; 5. I bëjmë thirrje BE-së të qëndrojë në krah të Ballkanit Perëndimor

për zbatimin e pasojave të krizës ekonomike dhe energjetike; dhe 6. Ne e afirmojmë përkushtimin tonë për dialogun si e vetmja mënyrë për t'i kapërcyer dallimet dhe çështjet e hapura në rajon", ka shkruar Pahor në "Twitter" derisa ka paraqitur konkluzionet e këtij samiti.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se thirrja për liberalizimin e vizave për Kosovën është miratuar njëzëri në procesin e Bërdo-Brionit. Ajo ka thënë se gjatë këtij viti pret që BE-ja të marrë vendim për këtë çështje, teksa ka shtuar se ka përkrahje në mesin e bllokut. "Aktualisht nuk ka vend në BE që na thotë se është kundër liberalizimit të vizave dhe besoj se e kemi momentumin më të mirë në këto katër vjetët e fundit. Pra, momentum është i shkëlqyeshëm, e kemi mbështetjen e vendit që është nikoqir i këtij takimi [të Këshillit të BE-së që mbahet në Republikën Çeke] dhe takimet ministrore. Shpresojmë që gjatë tetorit do të ketë takim të grupit punues për viza për ta shtyrë

çështjen përpara. Dhe pastaj në samitin e ri BE-Ballkan Perëndimor, që pritet të mbahet më vonë, pas tetorit. Ajo që është me rëndësi është që ky vendim të merret gjatë Presidencës çeke, pra gjatë këtij viti", ka thënë Osmani.

Ndërkaq presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, deklaroi se Bashkimi Evropian nuk është popullor në mesin e qytetarëve të Serbisë, por tha se shpreson se kjo do të ndryshojë në të ardhmen. "Unë vij prej një vendi i cili ndodhet në rrugën evropiane. Nuk do që të heq dorë prej saj, por në të cilin BE-ja është më së paku popullore. Nëse sot do të kishit një referendum në Serbi, në pyetjen: A doni të hyni në BE ose jo, qytetarët e Serbisë do të thoshin jo", tha Vuçiqi pas samitit të Procesit Bërdo Brioni. Ai, po ashtu, tha se shpreson se kjo do të ndryshojë "në muajt apo vitet e ardhshme".

Ai shtoi se një nga arsyet kryesore për këtë është çështja e integritetit territorial të Serbisë. Serbia konsideron se me pavarësinë e Kosovës, të shpallur më 2008, është shkëlqur

# Ekspertët: Rusia në pozitë të vështirë pas ofensivës ukrainase

Kundërofensiva e Ukrainës në pjesën verilindore të vendit duket se e kapi Rusinë në befasi në luftën gati 7 mujore. Tërheqja e shpejtë dhe kaotike e trupave në rajonin e Kharkivit, në të cilën disa armë dhe municione u lanë pas, ishte një goditje e madhe për imazhin rus. Kjo ishte humbja më e madhe ushtarake në Ukrainë që kur Moska tërhoqi forcat e saj nga zonat afër Kievit pas një përpjekjeje të dështuar për të pushtuar kryeqytetin në fillim të pushtimit.

Ofensiva ukrainase duket se ka lënë Kremlinin dhe Presidentin Vladimir Putin pa një përgjigje adekuate. Kjo ka zemëruar blogerët dhe nacionalistët ushtarakë rusë, madje ka ekspozuar disa përçarje të brendshme politike.

Presidenti rus Vladimir Putin nuk e përmendi gjendjen në Ukrainën verilindore gjatë inaugurimit të një parku kombëtar në Moskë. Në të vërtetë, kundërofensiva ukrainase duket se e ka vënë Kremlinin në një pozitë të vështirë.

Ministria e Mbrojtjes deklaroi se tërheqja e trupave kishte për qëllim forcimin e pozicioneve

ruse në Donbas, një justifikim disi i dobët, duke patur parasysh se zonat e kontrolluara nga Rusia në rajonin e Kharkiv-it siguruan një pikë kyçe të favorshme për operacionet e Moskës në rajonin jugor të Donetskut.

Ministria ruse e mbrojtjes nuk ka ofruar ndonjë hollësi në lidhje me tërheqjen, por ajo publikoi një hartë të dielën që tregon se trupat ruse ishin zbrapsur përgjatë një rripi të ngushtë toke në kufirin me Rusinë, një pranim në heshtje i përparimit të madh të forcave ukrainase.

Televizioni shtetëror rus dhe media të tjera të kontrolluara nga qeveria ndoqën shembullin, duke mos folur drejtpërdrejt për tërheqjen e trupave ruse.

Një video e publikuar nga ministria ruse e mbrojtjes tregoi një helikopter rus duke sulmuar trupat ukrainase që po përpiqeshin të kalonin lumin Oskil në një pjesë më parë të qetë në rajonin e Kharkivit, një pranim e shkallës së gjerë të sulmit ukrainas.

Shumë njëzëz në Rusi fajësojnë armët dhe luftëtarët perëndimor për mungesën e përparimit të ushtrisë ruse në Ukrainë. "Nuk

është Ukraina, por e gjithë NATO-ja që po na lufton", thotë Alexander Kots, një korrespondent lufte për gazetën pro-Kremlin "Komsomolskaya Pravda".

Ofensiva e re ukrainase, e cila ka rritur moralin e vendit ndërsa lufta kaloi ditën e 200 të dielën, mund të krijojë kushtet për përparim të mëtejshëm në lindje dhe gjetkë.

Por, ajo gjithashtu mund të shkaktojë një përgjigje edhe më të dhunshme të Moskës, duke çuar në një përshkallëzim të ri dhe të rrezikshëm të luftimeve. Të dielën mbrëma, raketat ruse goditën infrastrukturën ukrainase, duke shkakuar ndërprerjen e energjisë elektrike në disa rajone.

"Kremlini duket i befusuar dhe nuk ka dalë ende me një plan të shpjeguar këtë në avantazh të Rusisë, kështu që në një masë të madhe mediat po injorojnë lajmet e këqija në pritje të një direktive nga Moska", thotë Mark Galeotti, profesor në Kolegjin e Londrës, i cili ka specializuar në çështjet ruse të sigurisë.

Sipas tij, situata duket se po del jashtë kontrollit të Moskës.

Në një pasqyrim të ashpër të tensioneve të brendshme të provokuara nga sukseset e Kievit,

udhëheqësi rajonal i Çeçenisë, i mbështetur nga Kremli, Ramzan Kadyrov, kritikoi hapur Ministrinë Ruse të Mbrojtjes për "gabimet" që bënë të mundshëm përparimin e Ukrainës.

Kritikat nga zoti Kadyrov, i cili ka dërguar njësitë çeçene për të luftuar në Ukrainë dhe vazhdimisht ka bërë thirrje për veprime më agresive, kanë zbuluar përçarjet e reja mbi rrjedhën e luftimeve në Ukrainë.

Në anën tjetër, politikani liberal Boris Nadezhdin paralajmëroi në kanal "NTV" se Rusia nuk do të jetë në gjendje të mposht Ukrainën dhe bëri thirrje për negociatë.

Komentet e zotit Nadezhdin duket se pasqyrojnë dyshimet në rritje në disa qarqe të zyrtarëve rusë për të ardhmen e operacionit ushtarak në Ukrainë dhe mund të jenë pjesë e përpjekjeve për të nxitur ndryshime të mundshme të politikave.

Ofensiva ukrainase dhe dështimi i Kremlinit për të dalë me një përgjigje të shpejtë ka zemëruar nacionalistët rusë dhe blogerët ushtarakë, të cilët kritikuan Ministrinë ruse e Mbrojtjes për mungesë të aftësisë për të

parashikuar dhe penguar kundërofensivën.

Ukraina ka bërë një mobilizim të gjerë me synimin për të arritur krijimin e një ushtrie aktive me 1 milion luftëtarë. Rusia ka vazhduar të mbështetet në një kontingjent të kufizuar vullnetarësh, nga frika se një mobilizim masiv mund të nxisë pakënaqësi më të gjerë dhe të shkaktojë paqëndrueshmëri politike.

Rusia nuk është shprehur mbi numrin e trupave të saj të përfshira në luftë, por bazuar në vlerësimet e vendeve perëndimore, në fillim të luftës Kremli kishte planifikuar dislokimin e mbi 200,000 ushtarëve rusë në Ukrainë. Zyrtarët perëndimorë thonë se rekrutimi i vullnetarëve të rinj dhe përdorimi i kontraktorëve ushtarakë privatë nuk arritën të kompensonin humbjet e mëdha në betejë.

Ndonëse Moska nuk i ka raportuar humbjet e veta që nga marsi, kur tha se 1,351 ushtarë rusë ishin vrarë në muajin e parë të luftës, vendet perëndimore vlerësojnë se mbi 25,000 ushtarë rusë janë vrarë në Ukrainë dhe mbi 80 mijë ushtarë të tjerë janë plagosur, kapur ose kanë dezertuar.



integriteti i saj territorial. Por, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konstatuar më 2010 se pavarësia e Kosovës nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar.

Presidenti i Kroacisë, Zoran Millanović, tha se në takim nuk është biseduar për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,

që ka synim normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy vendeve. "Unë e mbështes njohjen e Kosovës. Të gjitha vendet që nuk e kanë bërë këtë, duhet ta bëjnë, por në këtë [samit] nuk ishte rasti për të", ka thënë Millanović.

Ai, po ashtu, ka thënë se do të bëjë gjithçka të mundur që

Procesi Bërdo-Brioni të vazhdojë, pasi Pahor përfundon mandatin e dytë presidencial këtë vit.

Procesi i Bërdo-Brionit është një nismë sllovene-kroate e ndërmarrë në vitin 2010 nga Pahor, atëbotë kryeministër i Sllovenisë.

Qëllim i saj është forcimi i

besimit të ndërsjellë në Ballkanin Perëndimor, bashkëpunimi rajonal dhe integriteti më i shpejtë i këtij rajoni në BE.

Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina kanë vetëm Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me BE-në, që është hapi i parë drejt anëtarësimit në

bllok.

Kosova, po ashtu, është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk ka liberalizim vizash me BE-në. Edhe pse Komisioni Evropian ka konfirmuar se ajo i ka plotësuar kushtet, disa vende, si Franca dhe Holanda, shprehin rezerva për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës.

## Krasniqi dhe Haradinaj shkruajnë në librin e zisë për vdekjen e mbretëreshës Elizabeth II



PRISHTINË, 12 SHTATOR - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka vizituar të hënën Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, për t'u shprehur ngushëllime ambasadorit Nicholas Abbott dhe bashkëpunëtorëve të tij për

vdekjen e mbretëreshës Elizabeth II. "Me këtë rast, nënshkrova edhe në librin e zisë, në kujtim dhe nderim të jetës së mbretëreshës Elizabeth II, udhëheqja, vizioni, përkushtimi dhe mirësia e së cilës kanë lënë gjurmë të

pashlyeshme në historinë e botës. Ngushëllimet më të thella, nga unë dhe gjithë Partia Demokratike e Kosovës, për Qeverinë dhe të gjithë qytetarët e Mbretërisë së Bashkuar", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në

"Facebook. Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka shkruar në librin e ngushëllimeve për mbretëreshën Elizabeth II në Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë. "Nderim për Lartmadhërinë e

Saj, Mbretëreshën Elizabeth II. Mirënjohës përjetë për solidaritetin e popullit britanik ndaj Kosovës. Falënderim ambasadorit Nicholas Abbott për kujdesin", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

## Deri në tri vjet pritje për shërbim në QKUK

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Zahrija Shala, një grua në të 50-tat nga Malisheva, thotë se i është dashur të presë tri vjet për të kryer një operacion në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). "Vetëm tash, pas gjithë asaj pritjeje, kam arritur ta kryej operacionin në këmbë", thotë Zahrija.

Ajo kishte probleme me venat e gjakut dhe është gati ta përfundojë rikuperimin në spital. Thotë se pritja e gjatë për operacion ia ka rënduar si sëmundjen ashtu edhe gjendjen psikologjike.

Si Zahrija janë edhe qindra pacientë të tjerë në klinika të ndryshme të QKUK-së, që presin me muaj apo vite për t'iu nënshtruar operacioneve. Disa nuk arrijnë, sepse vdesin ndër kohë.

Drejtori i Klinikës së Kirurgjisë Vaskulare, Hajriz Rudari, thotë se pritjet kanë qenë edhe më të gjata deri para dy vjetësh, kur klinika që udhëheq ai nuk ka pasur sallë operacioni dhe shërbimi është kryer në klinika të tjera.

Pritja ka zgjatur "katër deri në pesë vjet", thotë ai. "Tani kemi sallë operacioni, por kemi



mungesë të anesteziologëve", ka thënë Rudari për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas tij, pacientët e sëmurë rëndë trajtohen me prioritet, të tjerët presin. "Çështja e operimit të venave është patologji që edhe nëse pret, pacienti nuk rrezikon asgjë",

thotë Rudari.

Klinika e Kirurgjisë Vaskulare është e vetmja në Kosovë që merret me patologjinë e venave, të arterieve, të shputës diabetike e të tjera. Në gjashtë muajt e fundit aty janë kryer rreth 200 operacione - përfshirë raste urgjente dhe

nga lista e pritjes. Klinika funksionon me 13 kirurgë dhe ka 24 shtretër për pacientët nga gjithë Kosova.

Situatë e ngjashme me pritje është edhe në Klinikën e Radiologjisë të QKUK-së. Pajazit Ademi thotë se mjekët i kanë rekomanduar t'i bëjë

rrezatim krahit në muajin shkurt. Terminin për këtë shërbim, që njihet edhe si CT, e ka më 16 shtator.

"Prej muajit shkurt jam duke pritur. Kam pasur ta bëj në muajin e 11-të, por më kanë thirrur dhe ma kanë caktuar një datë për këtë muaj. Pritja është e mundimshme, por kur nuk ke para të shkosh në [institucion] privat, duhet të presësh", thotë ky pensionist nga Prishtina, duke u ankuar për përkeqësim të gjendjes shëndetësore.

Drejtoresha e Klinikës së Radiologjisë, Shkëndije Nuza, pranon se rastet ambulatore presin 10 deri në 11 muaj për shërbime, ndërsa të hospitalizuarit, sipas saj, kanë prioritet. "[Pritjet ndodhin] sepse në disa komuna të Kosovës nuk po kryhen rrezatime, edhe pse ato i kanë aparaturat", thotë Nuza për "Radion Evropa e Lirë", por pa specifikuar ndonjë komunë.

Në Klinikën e Radiologjisë punojnë rreth 30 radiologë dhe brenda ditës kryhen mbi 20 rrezatime. REL ka arritur ta shohë listën e pacientëve që presin për CT në këtë klinikë dhe për emrin e fundit në listë figuron data 1 gusht 2023.

## Një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes vizitoi Forcat e Armatosura të Zvicrës

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes ka realizuar një vizitë dyditore në Zvicër me qëllim të njohjes së sistemit të organizimit dhe funksionimit të Forcave të Armatosura të saj. Me këtë rast, delegacioni në përbërje prej këshilltarëve të kabinetit të ministrit Mehaj, Rabbit Konufca dhe Leureta

Lumi, si dhe zyrtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes, Gafurr Dugolli e Kosum Kosumi, u pritën nga shefi për Bashkëpunim Ushtarak dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Mbrojtjes, kolonel Markus Schefer, komandanti i Rekrutimit në Forcat e Armatosura të Zvicrës, kolonel Thomas Keller, si dhe

komandanti i Qendrës së Rekrutimit në Payerne, kolonel Alexandre Beau. "Kjo vizitë është e para në nivel të ministrisë dhe forcave tona në Zvicër, duke hapur kështu mundësinë për fillimin e arritjes në të ardhmen të bashkëpunimit zyrtar bilateral në mes të ministrive dhe forcave të dy vendeve tona", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.



# KMDLNj: Refuzimi i Kurtit për ta takuar Jasharajn e vështirëson situatën

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë thirrje që qeveria dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës të gjejnë zgjidhje për grevën në arsim. Sipas KMDLNj-së, gabimi kryesor i Qeverisë së Kosovës është se nuk e ka marrë seriozisht paralajmërimin për grevë nga SBASHK-u dhe deri vonë ka kundërshtuar çdo takim apo përpjekje për bashkëbisedim me kryetarin e saj Rrahman Jasharaj. "Për më keq figura kyçe në SBASHK është linçuar publikisht, është fyer në baza kombëtare dhe njerëzore nga zyrtarë qeveritarë dhe nga ata që janë të afërt me qeverinë aktuale. Në çdo reagim, deri më sot, KMDLNj ka deklaruar se greva mbetet vetëm si zgjidhje e skajshme kur shpenzohen të gjitha mundësitë për arritje të një marrëveshjeje e që KMDLNj mendon se nuk janë shfrytëzuar këto mundësi prandaj, pa të drejtë po e pësojnë 320,000 nxënës në Kosovë si dhe familjet e tyre", është theksuar në reagimin e SBASHK-ut.

KMDLNj ka theksuar se Qeveria e Kosovës, si ushtruese efektive dhe e mandatuar e pushtetit, është dashur të bëjë përpjekje të vazhdueshme që të evitohet greva e jo t'i shpërfillë kërkesat e SBASHK-ut për takim. "Kryeministri Kurti është dashur ta takojë kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, jo një herë por sa do të ishte e nevojshme në



mënyrë që të tejkalohet situata. Refuzimi i vendosur i kryeministrit Kurti ta takojë kryetarin e SBASHK, Rrahman Jasharaj e vështirëson shumë zgjidhjen e ngërçit të krijuar aq më parë që ministrat dhe vartësit e kryeministrit nuk dalin jashtë qëndrimeve të kryeministrit madje, për më keq me një fjalor fyes dhe kërcënues e fusin

çështjen në rrugë njëkahëshe, pa zgjidhje", është thënë në reagimin e SBASHK-ut.

KMDLNj ka thënë tutje se përpjekja e presidentes Osmani për të ndërmjetësuar ka qenë më shumë penguese sesa që e ka pasur qëllimin e mirë për faktin se nuk ka qenë asnjëherë në këtë angazhim. "Dhe në fund, për KMDLNj, edhe këmbëngulja e

SBASHK-ut dhe Rrahman Jasharaj se: 'ose 100 euro ose do të bëhet kijameti ...' nuk është e arsyeshme për faktin se nëse kërkoni ndërmjetësim dhe zgjidhje përmes dialogut atëherë nuk duhet dhe nuk mund të insistoni 100 % në qëndrimin tuaj. Sepse, nëse nuk ka gatishmëri për një lëshim nga pozitat fillestare pse atëherë duhet të bisedohet?! KMDLNj e kupton gjendjen e rënduar ekonomike të qytetarëve të Kosovës sikur edhe të punonjësve të arsimit mirëpo, aktualisht ka kategori shumë më të rrezikuara ekonomikisht e të cilat nuk bëjnë grevë prandaj këtë duhet ta ketë parasysh edhe SBASHK", thuhet në reagim.

KMDLNj kërkon që kryeministri Kurti të takohet me kryetarin e SBASHK-ut dhe Këshillin Grevist në përpjekje që të gjendet një zgjidhje, e pranuar nga të dyja palët "ndërluftuese" qoftë edhe për një afat të caktuar, deri te një

zgjidhje përfundimtare. "Fillimisht duhet të ndalet gjuha e urrejtjes, kërcënuese, degradues dhe linçuese ndaj kryetarit të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe anëtarëve të Këshillit Grevist e pastaj të fillojë një bashkëbisedim mirëkuptimi midis palëve në mënyrë që nxënësit të shkojnë në shkollë", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Për KMDLNj-në përgjegjësi në lidhje me këtë situatë do të kenë dy persona, siç ka theksuar "me fuqi të madhe vendimmarrëse në institucionet që drejtojnë, Albin Kurti, kryeministër i Kosovës dhe Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut". "KMDLNj thërret palët që urgjentisht të gjejnë një zgjidhje dhe nxënësit të fillojnë mësimin. Ndryshe, të dyja palët do të marrin përgjegjësi për shkelje të rënda dhe serioze të drejtave të njeriut për një arsim cilësor dhe të domosdoshëm!", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

## Të enjten debat në Kuvend lidhur me grevat

Seanca e parë për sesionin vjeshtor të Kuvendit do të mbahet të enjten më 15 shtator. Në këtë seancë, në mesin e shumë pikave të rendit të ditës, do të jetë edhe debati parlamentar lidhur me grevën e shërbyesve civilë dhe atë të arsimit.

Shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se opozita ka

propozuar debat parlamentar për grevën e përgjithshme të sindikatave dhe janë pajtuar që ta kenë si pikë të tetë të rendit të ditës në seancën e së enjtes.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka treguar se ka propozuar debat parlamentar rreth grevave të përgjithshme. "Nuk ka si të fillojë ndryshe sesioni vjeshtor pa një debat rreth grevave që po

ndodhin. Sot është java e tretë që fëmijët do të duhej të ishin në shkollë por kjo nuk po ndodh si rezultat i kokëfortësisë së kryeministrit dhe mungesës së një dialogu social me sindikatat. Kjo kokëfortësi e kryeministri po i bënë dëm Kosovës dhe më së shumti fëmijëve. Shpresojmë që deri të enjten të gjendet një zgjidhje dhe të fillojë mësimi", ka thënë Tahiri.

## Abetarja e përbashkët unike Kosovë - Shqipëri promovohet edhe në Tiranë

TIRANË, 12 SHTATOR - Pas promovimit në Gjakovë, Abetarja e përbashkët unike Kosovë - Shqipëri është promovuar edhe në Tiranë. Të pranishëm në këtë promovim ishin kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ministrja e Arsimit të Kosovës, Arbërie Nagavci dhe ajo e Shqipërisë, Evis Kushi.

Kryeministri Rama ka thënë se Abetarja e përbashkët është një tekst i shumëpritur për nxënësit shqiptarë të Shqipërisë, Kosovës e më tej kudo ata ndodhen, që të

mësojnë gjuhën amë, shqipen e mirë, të ëmbël e të dëlirë, siç i këndonin me plot pasion e të drejtë rilindësit shqiptarë.

Ministrja Nagavci ka thënë se kur flasim për Abetaren, natyrshëm na vijnë në mendje të gjithë ata atdhetarë e intelektualë që i vunë themelet e bënë rrugë të gjatë dhe plot sakrificë për ruajtjen e identitetit dhe vlerave kombëtare që na bashkojnë. "Kujtojmë edhe gjithë atë plejadë mësuesish që ngritën breza të tërë duke luftuar

analfabetizmin dhe paditurinë për të ngritur kështu një komb të tërë drejt një shoqërie të emancipuar, të ditur e konkurruese me botën e zhvilluar. Tash të gjithë së bashku le ta bëjmë historinë e ruajtjes së gjuhës, kulturës, arsimit dhe fuqizimin e kombit shqiptar. Shfrytëzimi i potencialit të dy vendeve tona na bën shumë më të fortë dhe shumë më të lehtë për arritjen e synimeve tona të përbashkëta për arsimim më cilësor", ka thënë Nagavci.



## Bie furnizimi me rrymë, rritet industria përpunuese gjatë muajit qershor

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Ka rënë furnizimi me rrymë dhe gaz, kurse ka pasur rritje të industrisë përpunuese, thuhet në raportin "Statistikat afatshkurtra të industrisë, qershor 2022", prezantuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK). "Në muajin qershor të vitit 2022 indeksi i

qarkullimit në sektorët e industrisë, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (qershor 2021), kishte rritje të furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 6.10 për qind dhe industria përpunuese me 0.70 për qind", thuhet në raport. Kishte rënie të furnizimi me

rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 0.82 për qind dhe industria nxjerrëse me 0.72 për qind. Struktura e numrit të punëtorëve kishte rritje tek industria nxjerrëse me 0.03 për qind dhe furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 0.02 për qind.




## Besnik Tahiri: Bizneset janë në prag të falimentimit

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, kërkon që zbatimi i Ligjit të Pagave të hyjë në fuqi më 1 janar të 2023-s. Tahiri në një konferencë për medie të hënën ka treguar se është kërkuar një interpelancë parlamentare për ministrin e Financave, Hekuran Murati, duke shtuar se bizneset në vend janë në prag të falimentimit financiar. "Ne kemi kërkuar një interpelancë për ministrin e Financave, për arsye se gjendja në sektorin privat është tepër e rënduar, mirëpo jemi pajtuar se çështja e grevës është një temë me rëndësi. Ne si GP i AAK-së nuk mund të sillemi zakonshëm, prandaj e mbështesim dhe do ta adresojmë këtë temë", ka thënë Tahiri. Sipas tij, nuk ka logjikë që Ligji i Pagave të hyjë në fuqi në fund të

vitit të ardhshëm. "Ne si grup parlamentar i kemi disa prioritete. Në radhë të parë është miratimi i Projektligjit të Pagave, njëkohësisht fillimi i zbatimit të tij më 1 janar 2023. Nuk ka logjikë që ky ligj të vazhdojë të jetë pjesë e diskutimeve publike e të hyjë në fuqi në fund të vitit të ardhshëm", theksoi ai. Gjithashtu, Tahiri u shpreh se gjendja energjetike në vend është e rëndë dhe se duhet hapur diskutimi publik për këtë çështje. "Çështja e dytë është aspekti që lidhet me energjinë. Siç e dini, kemi pasur tryeza, diskutime e debate për këtë temë dhe mendojmë se gjendja energjetike, gjithandej Evropës, në veçanti në Kosovë, është shumë e mangët dhe ne mendojmë se ngritja e debatit rreth kësaj teme është e rëndësishme së veçantë", u shpreh Tahiri.



## Mbi 37 mijë vizitorë vendas e të huaj qëndruan në hotelet e Kosovës në muajin qershor

EPOKA  
ERE

ALBULENA S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Për dallim nga muaji qershor i vitit të kaluar, në qershorin e sivjetmë numri i vizitorëve vendas dhe të huaj që qëndruan në hotelet e Kosovës është më i lartë. Të dhënat nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) tregojnë se numri më i madh i tyre u përqendrua në rajonin e kryeqytetit.

Në muajin qershor numri i vizitorëve që qëndruan në hotelet e Kosovës ishte mbi 37 mijë. "Sipas anketës, numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) ishte 37 292, prej tyre 30.59 % ishin vizitorë vendorë dhe 69.41 % ishin të jashtëm, ndërsa numri i net-qëndrimeve ishte 64 271, prej tyre 25.36 % nga

vendorët dhe 74.64 % nga të huajt", thuhet në komunikatën e këtij institucioni.

ASK-ja tregon se numrin më të madh të vizitorëve dhe net-qëndrimeve të tyre e pati rajoni i Prishtinës me 16 989 vizitorë dhe 29 626 net-qëndrime.

Më tutje thuhet se numri më i madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Pejë, Prizren e kështu me radhë. Kurse sa iu përket vizitorëve të huaj, numri më i madh i tyre ishte nga Shqipëria, Gjermania, Turqia etj.

Nga muaji qershor i vitit të kaluar numri i vizitorëve është më i lartë për 13 741. Në muajin qershor 2021 numri i vizitorëve ishte 23 551.

Pjesë e anketës ishin 209 hotele që ushtrojnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës.

## Dogana parandalon kontrabandën e 1 000 kilogramëve të ushqimeve

PRIZREN, 12 SHTATOR - Dogana e Kosovës ka njoftuar se ka parandaluar një kontrabandë të produkteve ushqimore në regjionin e Prizrenit. "Në

regjionin e Prizrenit, respektivisht segmentin Vermicë - Prizren, njësitet e antiktrabandës kanë ndaluar një automjet të

dyshimtë. Pas ekzaminimit të tij, në të janë gjetur mallra pa dokumentacion përcjellës, pra mallra të kontrabanduara në Kosovë. Me këtë rast janë

sekustruar rreth 1 000 kilogramë produkte ushqimore si dhe ka filluar procedura kundërvajtëse", ka njoftuar Dogana.





# Poezi e dinjitetit mbi gërmadha (mbi krijimtarinë e Xhevdet Bajrajt)

Nga Shqiptar OSEKU

"lëre derën hapur  
mbaje dritën ndezur në zemër  
që ta di se ku të kthehem"

-Xhevdet Bajraj

Ekziston një teori e diskutueshme, determinizmi nominativ, që thotë se personaliteti i njerëzve saohet nga emërtimet: nga fjalët me të cilat pagëzohet njeriu a vendi ku është rritur ai. Në rastin e poetit Xhevdet Bajraj, kjo teori mund të jetë dyfish e saktë. Emri i tij, si shumë tjerë të proveniencës muslimane, është nga arabishtja dhe dmth Ekselent, në shqip mbase do të thonim Shkëlqim a Shembullor. Emërtim ky i goditur për një nga poetët më të shkëlqyer të poezisë shqip në Gegërinë e veriut, të lindur më 1960, i cili u shqua që në poezitë e para si zë origjinal, me gjuhë idiosinkretike e mesazh të emancipuar e të ankoruar në rrymat letrare të kohës. Tri përmbledhjet e tij të para në Prishtinë e pushtuar të viteve 1990 ishin kumtare të një pranie të re poetike; përmbledhja e tretë "Emblema e Vdekjes" (1993) fitoi cmimin e librit më të mirë të poezisë nga Shoqata e shkrimtarëve të Kosovës.

Që atëhere, Xhevdet Bajraj ka fituar edhe një sërë cmimesh tjera, një cmim të dytë të Shoqatës së shkrimtarëve më 2000, cmimin ndërkombëtar të Goliardos për poezi më 2004, cmimet Katarina Josipi më 2010 dhe atë të Festivalit Monodrama në Vlorë më 2013 për dramën më origjinale në shqip, si dhe cmimin për librin më të mirë në panairin ndërkombëtar të librit në Prishtinë më 2015, midis tjerash. Që nga dëbimi nga Kosova gjatë luftës më 1999, kur atij iu dha strehë letrare në Meksikë, Xhevdet Bajraj punon si ligjërues me orar të plotë i shkrimit krijues pranë universitetit në Meksiko City, ndërsa poezia e tij është përkthyer në spanjisht, anglisht, gjermanisht, polonisht, hungarisht, serbisht, turqisht, sllovenisht, e danisht. Dy botimet i tij të radhës në anglisht, përmbledhja poetike "We Fall Like Children" (2018) dhe drama në vargje "Slaying the Mosquito" (2020), u botuan në përkthim kongjental nga Ani Gjika e Alice Whitmore tek shtëpia botuese amerikane Laertes Books.

Mirëpo, teoria për ndikimin deciziv të emrit mund të argumentohet edhe me vendlindjen e tij parajsore, qytezën e Rahovecit. Banorët e atjeshëm janë shumica pasardhës të shqiptarëve të dëbuar nga cepet më veriore të Gegërisë, që u shpupulluan nga Serbia më 1878. Ndodhur në mes të artë midis Gjakovës e Prizrenit, Rahoveci ka ngelur në hartë me emërtimin e sajuar sllav Orahovac, shqip: arrishtë, ndonëse atje arrat s'janë kultivuar kurrë. Pokorny Julius, tek Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch (1959) aludon se toka e shndrydhur dhe e lërueshme, në shqip "ara" nga protoindoeuropianishtja "harah",



do t'i kenë dhënë atij vendi emërtimin e vet të parë. Lugina ku ndodhet qyteza e vogël ka kushtet klimatike të Burgundisë franceze, me kombinim të përsosur të diellit e dëborës gjatë vitit. Anët ku është rritur Xhevdet Bajraj janë treva e vetme në tërë Siujdhesën ilirike ku ka gjetur kushtet të rritet si në shtëpi të veten hardhia Pinot noir, ky princ i ndieshëm i Burgundisë. Jo rastësisht, poezia e Xhevdet Bajrajt është e mbarsur me hardhi e musht ujze (rakie) e vere, e histori hijesh që rreken të mbijetojnë emrin e vet, si dhe dëbimet e vdekjet e veta. Këto kanë stampuar si sigla të fatit edhe vargjet e Xhevdet Bajrajt.

Te ExLibris sot, mund të lexojmë për herë të parë pesë poezi të pabotuara nga Xhevdet Bajraj, pjesë nga një përmbledhje në dorëshkrim. Poezia e mirë nuk saohet dot në vakuum letrar. Kritiku i vëmendshëm letrar te poezia e Bajrajt i ndien ndikimet e eminecave gri të epokës, Ali Podrimja, Fatos Arapi, Vasko Popa, Danillo Kish, Paul Valery, e Caslav Millos, por edhe ato të lirikëve latinamerikanë. Vetë Bajraj në një intervistë te Epoka e Re ("Kërkues kokëfortë i parajsës së humbur", 2019) u referohet autorëve Vincent Huidobro, Juan Rulfo, Juan José Arreola, Carlos Fuentes, e José Emilio Pacheco, si objekt të studimeve të tij. Por lajtmotivi i përsëritur i poezisë së Bajrajt, parajsa e shkretëruar dhe lufta e qenies njerëzore për një fije dinjitet mbi gërmadha, të kujton edhe antologjinë e Manuel Monteros (1973) mbi poetët latinamerikanë që shkruan për drejtësi sociale, Octavio Paz, Juan Banuelo, e Efrain Huerta meksikanë, Alfonsina Storni e Francisco Urondo argjentianë, César Vallejo e Alejandro Romualdo peruanë, si dhe Gabriela Mistral e Pablo Neruda kilianë. Përmbledhja "Poemas y antipoemas" nga Nicanor Parra (1975) që është përkthyer edhe anglisht është thuasë në dialog poetik ndër kohë e hapësirë me opusin e Xhevdet Bajrajt. | exlibris.al

Jashtë  
bëhet fushatë politike  
janë zgjedhjet  
votohet për vrasës  
(me dhe pa pagesë)  
për hajna  
për mashtrues  
dhe për sklevërit e tyre

Hoxha ia fut ezanit kot  
kot bien edhe këmbanat e kishës  
Zoti na ka trajtuar me dinjitet  
duke na dhënë vullnet të lirë  
fuqinë për të marrë vendime tona  
politikanët nuk na japin këtë mundësi

Nënë  
De Niron do ta vrasin në fund të filmit  
po dal unë ta pi ndonjë birra  
të lutem për ne të dy  
në njërin nga kafenetë e qytetit  
mos ke dert  
nuk do të pi nëpër rrugët  
që mbajnë emra heronjesh të shpifur  
sapo mora vesh që në rrugën Shën Nëna Terezë  
një vrasës e kishte hapur një taverne të re  
dhe të lutem  
lëre derën hapur  
mbaje dritën ndezur në zemër  
që ta di ku të kthehem

## SA HERË E KUJTOJ ATDHEUN

Është ujku i zbutur  
brenda një peizazhi të xhunglës urbane  
që pikturoi një fëmijë demon  
Sa herë e kujton atdheun e parë  
brenda gjoksit të tij  
zoti i ujqërve të zbutur ulërinë

Kjo këtu është një lule egër  
e cila edhe pse për herë të parë ka çelur  
këtë e ka bërë në mënyrë të përsosur  
Shumë shpesh e kujton atdheun  
e kur ndodh kjo  
e liron një aromë të përsosur

Ky këtu jam unë  
për nevoja të mia e kam zbutur ujkun  
dhe lules ia kam dhënë emrin e nënës sime  
Sa herë ta kujtoj atdheun  
e ndjej mëngën e majtë të vdekjes  
duke ma fshirë gjakun nga hunda

## KUR BOTA ISHTE TEPËR E MADHE

Mendonte se i duhej të thoshte diçka  
në letër  
diçka të thellë  
por nuk i binte asgjë ndërmend

Pas pak iu kujtua koha  
kur luante me këmbë të zbathura  
në rrugë  
deshi të thoshte diçka në lidhje me këtë  
kur bota ishte tepër e madhe  
e ëndrrat tepër të vogla  
Një sorrë krokati në dritaren e hapur  
uni lirik i tij i zgjati duart  
dhe ia nxori kokën me rrënjë

Në pasqyrën në mur trupi i tij dridhej  
para se të binte në tokë  
pa kokë

Ca muzikantë rruge  
e këndonin një këngë që kishte korr sukses  
atë verë  
të zymtë

## KAFE ME NËNËN

Frynte një erë plakë në vjeshtën që po lindte  
Është ditëlindja e Irfanit të vrasës para njëzet vjetëve  
gjetet e pjergullës biejnë  
mbi flokët e zbardhura të nënës  
ajo nuk sheh mirë  
nuk dëgjon mirë  
jemi vetëm në mes të parajsës së djegur  
derisa ajo në kujtime e saja gatuate bukë për  
babain tim  
për mua dhe për veten  
në Tiranë në banesën e Martin Cukallës  
unë pija raki Skrapari me Nexhat Dibrën

Piku një mollë dhe e theu heshtjen  
bir  
pse disa viteve u mungojnë muajt  
Rashë nga qielli i shtatë  
në këmbë  
si mace që i kishte mbetur vetëm një shpirt  
Nga molla e rënë doli një krimb si derr i luftës  
që e kishte majmur liria

Pije kafënë nënë  
pije  
janë vite të krimbura

## SHTËPITË E BRAKTISURA

Nga dritarja po e shiqonte qytetin  
qiellin Zoti para se ta braktiste  
e kishte pastruar me fshisë  
kështu që ishte i pastër  
si loti i një burri  
që po fliste me të vdekurit e tij

Sorrat të majmura krokërisnin në degët e pemëve  
nëpër oborret e shtëpive të braktisura  
që shumica e banorëve të tyre kishin ikur  
për të mos u kthyer kurrë  
dyert i kishin lënë të hapura  
çelësat ishin në dyer  
dritaret ishin të hapura  
që njerëzit nëpër fotografitë e varura në mure  
të merrnin frymë  
DE NIRON DO TA VRASIN

## NË FUND TË FILMIT

Mes rrënojave të asaj që dikur ishte parajsë  
bën ftohtë  
aq ftohtë sa që edhe pemët dridhen  
i hedhin frutat  
Brenda shtëpisë  
nëna po vdes ngadal e ulur në kolltuk  
duke e shikuar një film me De Niron



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Ademi takohet me menaxherin e futbollit nga Italia, Andrea D'Amico

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, priti në takim menaxherin e futbollit nga Italia, Andrea D'Amico. D'Amico e njoftoi presidentin Ademi se qëllimi i ardhjes së tij në Kosovë është interesimi ndaj klubit SC

Gjilani, me zyrtarët e të cilit veçse ka biseduar gjatë të dielës, po ashtu identifikimi i talenteve kosovarë dhe mundësia që futbollistët e Kosovës të transferohen në klubet evropiane. Ndërsa qëllimi i takimit me kryetarin Ademi,

sipas njoftimit të FFK-së, ishte informimi nga afër për zhvillimin e futbollit kosovar, për çka edhe e përgëzoi të parin e FFK-së teksa u diskutua edhe për gjetjen e formave për bashkëpunim me të rinjtë kosovarë.

Kryetari Ademi e falënderoi menaxherin Andrea D'Amico për interesimin ndaj futbollit dhe futbollistëve të Kosovës teksa e njoftoi atë se futbollit vitet e fundit ka shënuar përparim, pasi që po zhvillohet me hapa të shpejtë, të sigurt dhe të suksesshëm.



# Sonte superndeshja Bayern - Barcelona

Barcelona kërkon hakmarrje në përballje me Bayernin, pasi në katër ndeshjet e fundit ka pësuar humbje. Fitoren e fundit ndaj gjermanëve e kanë regjistruar në vitin 2015 me dy gola të Leo Messit dhe një të Neymarit

### "Epoka e re"

MÜNCHEN, 12 SHTATOR - Dy nga klubet më të mëdha në futbollin evropian, Bayern Munchen dhe Barcelona, do të përballen sonte (e martë) në kuadër të grupit C, që konsiderohet si grupi i vdekjes në Ligën e Kampionëve. Kampioni në fuqi i Gjermanisë, Bayern, e nisi sezonin e ri në garën më të fortë me fitore ndaj Interit në Itali, kurse me fitore bindëse startoi edhe Barcelona, por ndaj një kundërshtari me pak të vështirë Viktoria Plzen (2-1). Bayerni u eliminua çuditërisht edicionin e kaluar në çerekfinalet nga Villarreali, por ai është gjashtë herë fitues i këtij kompeticioni, me suksesin e fundit që e arriti në vitin 2019-2020, kur shënoi fitoren 1-0 ndaj Paris Saint-Germainit në finale. Mirëpo "bavarezët" kanë barazuar në tri ndeshjet e fundit kundër Borussia Monchengladbachut, Union Berlinit dhe Stuttgartit. Në anën tjetër, Barcelona sezonin e kaluar nuk arriti të kalojë fazën e grupeve, që ishte hera e katërt e



### Formacionet e mundshme:

**Bayern Munchen:** Neuer; Pavard, De Ligt, L Hernandez, Davies; Kimmich, Sabitzer; Gnabry, Muller, Sane; Mane.

**Barcelona:** Ter Stegen; Kounde, Araujo, E Garcia, Balde; Gavi, Busquets, Pedri; Raphinha, Lewandowski, Dembele.

një rezultati të tillë në histori të klubit, kurse hera e parë nga sezoni 2000. Në këtë edicion skuadra nga "Camp Nou" është krejtësisht tjetër për faktin se gjatë verës ka bërë shumë transferime, përfshirë edhe sulmuesin e Bayern Munchenit, Robert

Lewandowski. Kjo e ka ndihmuar këtë klub të ketë start të fuqishëm në Ligën e Kampionëve dhe në La Liga. Ndeshjen e fundit skuadra e Xavit ka shënuar fitore kundër Cadizit me rezultat 4-0. Për këtë ndeshje vendësve u mungojnë Kingsley Coman dhe Bouna Sarr,

GRUPI A		GRUPI C	
21:00 Liverpool - Ajax		18:45 Viktoria Plzen - Inter	
Tabela		21:00 Bayern Munich - Barcelona	
1. Ajaxi	3 pikë	Tabela	
2. Napoli	3	1. Barcelona	3 pikë
3. Liverpooli	0	2. Bayern Munchen	3
4. Rangers	0	3. Inter	0
GRUPI B		GRUPI D	
21:00 Bayer Leverkusen - Atletico Madrid		18:45 Sporting CP - Tottenham Hotspur	
21:00 Porto - Club Brugge		21:00 Marseille - Eintracht Frankfurt	
Tabela		Tabela	
1. Atletico M.	3 pikë	1. Sporting CP	3 pikë
2. Club Brugge	3	2. Tottenham H.	3
3. Porto	0	3. Marseille	0
4. Leverkusen	0	4. Frankfurt	0

kurse mysafirët janë të kompletuar. Kjo ndeshje do të jetë e veçantë për sulmuesin Robert Lewandowski që rikthehet në "Alianz Arena" për herë të parë pas largimit dhe presidenti ish-klubit të tij, Herbert Hainer, ka bërë thirrje që të pritet ngrohtësisht. "Shpresoj, dhe është dëshira ime e madhe, që tifozët të jenë të sjellshëm me Robertin dhe të kenë një pritje miqësore, sepse ai luajti tetë vjet me ne, shënoi

shumë gola dhe vendosi shumë ndeshje. Falë golave të tij ne fituam shumë tituj të mëdhenj. Në fund, të gjithë morën atë që dëshironin, Roberti shkoi në 'Camp Nou', Barcelona është e lumtur që ka Lewandowskin dhe ne kemi bërë para për të investuar në të ardhmen tonë. Secili duhet të ndihet mirë me zgjedhjet e tij. Shpresoj që tifozët tanë t'i urojnë mirëseardhje polakut", ka thënë Hainer.

## Kuka, prindërve: Dërgoni fëmijët në xhudo



PEJË, 12 SHTATOR - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, u ka bërë thirrje prindërve t'i dërgojnë fëmijët në sportin e xhudos. Kuka ka folur edhe për grevën në arsim që ka hyrë në javën e tretë, derisa ka shtuar se mësimi duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

"Çfarë situatë e çmendur me hyrjen në javën e tretë pa filluar mësimi në shkollë! Ec more me urgjencë me bë takim. Merruni vesh qysh sot e le të filloj mësimi nesër jo ma vonë asnjë ditë", ka shkruar Kukanë në profilin e vet në "Facebook". "E në anën tjetër

ftoj prindërit që fëmijët që tash në shtator pos mësimi që duhet qysh nesër të fillojë të dërgojnë fëmijët drejt sportit të xhudos por edhe sporteve tjera!", ka shtuar Kuka, i cili për një ditë të mirë ka shpërndarë një video me fëmijët kampionë të ardhshëm pas një stërvitjeje.

## Kastrioti ndalet në Kupën Evropiane

FERIZAJ, 12 SHTATOR - Kastrioti i Ferizajt është ndalur në raundin e parë të Kupës Evropiane në hendboll. Ferizajasit e kanë humbur edhe ndeshjen e dytë ndaj

Gračanicës, të luajtur të dielën në Bosnjë-Hercegovinë. Skuadra vendase fitoi me rezultat 36:22. Ferizajasit kanë bërë përpjekje, por cilësia ishte në

anën e skuadrës boshnjake. Në Kupën Evropiane paraqiten edhe Besa Famgas e Rahoveci, që startojnë prej raundit të dytë. Te hendbollistët në Kupën

Evropiane paraqiten Istogu e Ferizaj. Kastrioti është kthyer në gara evropiane pas tri vjetësh. Tani u kthehet ndeshjeve në Superligë dhe ka synime të mëdha.



## Federeri rikthehet pas një viti mungesë

CYRIH, 12 SHTATOR - Roger Federeri është gati për t'u rikthyer në fushë. Tenisti zviceran, fitues i 20 grand slameve, ish-numri 1 në botë, ka zyrtarizuar praninë e tij në turneun e Bazelit (Zvicër), që do të zhvillohet më 22-30 tetor.

Ndërkohë që më herët, më 23-25 shtator, ai do të luajë në turneun e Laver Cup, ku do të jetë pjesë e Evropës në ndeshjen ndaj botës. Në këtë turne të organizuar prej tij, Federeri do të luajë bashkë me Nadal, Djokovicin e

Murrayn. Federeri nuk luan prej më shumë se një viti, që kur u eliminua nga Wimbledon 2021. Ai kreu një operacion në gju dhe rikuperimi ka zgjatuar shumë. Fakti që ai rikthehet në fushë në një turne ATP është i

rëndësishëm për të dhe fansat e tij. Turneu i Bazelit është i preferuari i Federerit, pasi zhvillohet në vendlindjen e tij. Në këtë turne do të jenë edhe mjaft tenistë "big", përfshirë edhe numrin 1 në botë, spanjollin Carlos Alcaraz.



## Mba për herë të dytë fiton çmimin 'ylli i javës'

PRISHTINË, 12 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, "Albi Mall", vazhdojnë të japin çmimin "ylli i javës". Çmimi i më të mirit në javën e gjashtë në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Trepça '89, Christian Mba. Për sulmuesin Mba kjo është hera e dytë që e fiton çmimin e 'Yllit të Javës' në këtë edicion, pasi të njëjtin e kishte fituar edhe në javën e parë. Komisioni vlerësoi se Mba ishte protagonist kryesor në fitoren që Trepça '89 e arriti si mysafir në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj kundër Drenicës me rezultat 5-2.

Christian Mba, përveç se shënoi dy gola (28', 90'), asistoi edhe në golat e shënuar nga Bleon Sekiraja (24') dhe Erdin Dushi (52'). Çmimin "ylli i javës" për futbollistin e Trepçës '89 e dorëzoi drejtori i marketingut në "Albi Mall", Albi Humolli. Pas vlerësimit për herë të dytë me çmimin "Ylli i



Javës", Christian Mba ka thënë se ndihet i lumtur për ecurinë e mirë të tërë ekipit. "Është një fillim i mrekullueshëm për mua dhe për skuadrën time. Jam këtu për të dhënë më të mirën time. Ky çmim nuk e pasqyron vetëm lojën time, por edhe punën ekipore të bashkëlojtarëve të mi dhe të

shtabit teknik. Ne me të vërtetë po e bëjmë më të mirën me punë. Do të punojmë me përkushtim që të jemi në pjesën e epërme të renditjes dhe, pse jo, ta rikthejmë trofeun e kampionit në Mitrovicë dhe ta bëjmë të lumtur secilin qytetar të Mitrovicës", ka thënë Mba.

## Broja më i kushtueshmi nga lojtarët kuqezi

TIRANË, 12 SHTATOR - Hierarkia e futbollistëve të Kombëtares së Shqipërisë ka ndryshuar sa iu përket vlerave në treg. Duke iu referuar faqes së specializuar Transfermarkt, në harkun kohor të një viti, vlerat e kuqezinjve kanë pësuar ndryshime, teksa emra të rinj kanë ngjitur shkallët në këtë renditje. Nëse pak kohë më parë në majë ishte mbrojtja, tani shohim që Armando Broja ka kaluar në krye. Sulmuesi vlerësohet me 22 milionë euro, 20 fish më shumë se dy vjet më parë. Kumbulla i Romës që mbante fronin, tani është në vendin e tretë me 16 milionë euro dhe sipër tij mbetet Gjimeshi me 17. Të dy mbrojtësit kanë pësuar një rënie në vlerën e tyre. Në vend ka mbetur Nedit Bajrami i cili mban vlerën 10 milionë euro, ndërsa në këtë shifër i është bashkëngjitur Kristjan Asllani, i cili u transferua tek Interi. 27-vjeçari Tomas Strakosha vijon listën me



kartonin që i vlen 7 milionë euro dhe pas tij Hysaj dhe Çekiçi me nga pesë. Ky i fundit ka pësuar një rritje me 3 milionë euro. I radhës vjen nga Spanja me Keidi Baren që i vlen kartoni 4 milionë, ndërsa Vrioni i

transferuar në ShBA 3.5. Qazim Laçi, i cili po luan në elitën franceze, vlerësohet 3 milionë, po aq sa ai edhe Myrto Uzuni. Më tej, lista vijon me Balliun, Ismajlin, Manajn, Muçin e të tjerë.

### SHKURT

#### Ballisti Morina lirohet nga burgu

Ismail Morina, i njohur më shumë si Ballist Morina, është liruar nga hetimet plotësisht. Gjykata e Apelit në Durrës vendosi për lirimin e Morinës i cili kishte dalë nga qelia pak muaj më parë, por po hetohej në gjendje të lirë. Ai u arrestua nga policia e Kukësit teksa po kthehej nga Kosova pasi nuk kishte shlyer 5 muaj burg për armëmbajtje pa leje. Ballist Morina u bë i njohur pasi ngriti dronin me flamurin shqiptar në Beograd.

#### Carlos Alcaraz triumfon në US Open dhe merr fronin

Adoleshenti spanjoll Carlos Alcaraz përmbushi ëndrrën e tij si një kampion i ardhshëm i Grand Slamit duke mposhtur Casper Ruud në finalen e US Open. Alcaraz fitoi 6-4 2-6 7-6 (7-1) 6-3 në finalen e tij të parë të madhe. 19-vjeçari është kampioni më i ri në Grand Slam për meshkuj qëkur Rafael Nadali fitoi French Open në 2005. Alcaraz zëvendëson Daniil Medvedev të Rusisë në krye, duke u bërë adoleshenti i parë që ngjitet në samit në historinë 49-vjeçare të renditjes ATP.

#### Motta emërohet trajner i Bolognas

Ish-mesfushori i Barcelonës dhe Interit, Thiago Motta, do të nisë një aventurë të re si trajner, tashmë në krye të skuadrës Bologna. Është faqja zyrtare e klubit italian që ka njoftuar marrëveshjen me Motta. Ky i fundit ka bërë tashmë një përvojë në Serinë A, ku ka drejtuar skuadra si Genoa dhe Spezia. Mbetet të shihet se si do t'ia dalë italianin në aventurën e tij me Bologna.

#### Casillas zgjedh pesë portierët më të mirë në botë

Portieri legjendar spanjoll, Iker Casillas, ka zgjedhur pesë portierët që, sipas tij, janë më të mirët në botë aktualisht. Ai opinionin e dha për "4-3-3". Ish-portieri i Real Madridit zgjodhi Thibaut Courtois si më të mirin, me belgun që tash e disa vjet është pjesë e "Los Blancos". Casillas në vendin e dytë e renditi portierin e Manchester Cityt, Ederson, teksa ai i Atletico Madridit, Jan Oblak, e mbyll treshen e parë. 41-vjeçari i dha vendin e katërt portierit të Barcelonës, Marc-Andre ter Stegen dhe të pestin Manuel Neuer të Bayernit Munichit. Ndryshe, Iker Casillas vlerësohet një nga portierët më të mirë në historinë e futbollit. Ai fitoi trofe të shumtë te Real Madridi, teksa karrierën e mbylli te Porto.

## Trajneri i PSG-së lavdëron Neymarin

Neymari po merr përdore skuadrën e PSG-së këtë sezon, me brazilianin që është shndërruar në lojtarin kyç të kampionëve të Ligës 1. Në 9 ndeshje të luajtura këtë sezon, ish-sulmuesi i

Barcelonës ka arritur të shënojë 10 gola, duke qenë një nga protagonistët kryesorë në rezultatet pozitive që parisienët kanë koleksionuar, ndërsa ka asistuar në 7 raste për shokët

e ekipit.

Trajneri Christophe Galtier i ka thurur elozhe brazilianit, teksa nuk ka nguruar ta quajë si një nga lojtarët më të mirë në planet. "Unë gjithmonë e kam

konsideruar atë si një nga lojtarët më të mirë në planet, por kam një sy shumë më të informuar dhe më të mprehtë për angazhimin e tij të përditshëm. Këtë e shoh para, gjatë dhe pas seanceve

stërvitore. Ai është shumë i investuar në nivel personal, por edhe në interes të ekipit. Ai është një profesionist dhe lojtar i madh. Unë e zbuloj atë me kënaqësi çdo ditë", ka thënë Galtier.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

